

Sa i përket përbërjes multietnike të anëtarësisë, ajo aspak nuk paraqet ndonjë problem, por përkundrazi ne si pensionistë jemi promotorë të bashkëjetesës në mjedisin tonë

Inderuari kryetar, fillimisht në pika të shkurta në bëni një përshkrim të SHP Tetovë.

Memti: Shoqata e pensionistëve Tetovë është ndër shoqatat më të vjetra të pensionistëve në Maqedoni. Ajo u formua në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar. Në vitin 1970 u ndërtua Shtëpia e pensionistëve në Tetovë, në bazë solidare nga ndërmarrjet e atëhershme ndërtimore nga Tetova "Ilinden", Tetovogradba dhe Luboten". Një pjesë e mjeteve janë siguruar nga ish SIZ për SPIM me marrëveshje vetëqeverisëse si mjete të pakthyeshme për ndërtimin e Shtëpisë së pensionistëve, në tokën ndërtimore të dhënë nga Komuna e Tetovës me Vendim për shfrytëzim të përhershëm. Sot SHP Tetovë numëron rreth 14.000 pensionistë (të vjetër dhe familjarë) dhe është organizuar në parim territorial të gjashtë komunave të rajonit të Pollogut të poshtëm. Ajo është e organizuar në 22 degë, prej të cilave 7 janë në qytet, ndërsa të tjerat janë në mjediset më të mëdha rurale.

SHP Tetovë është shoqatë multietnike. Çka ju nxititi të pranoni që të jeni njeriu i parë i një shoqate të këtillë? A ka probleme në planin multietnik?

Memti: Unë jam prezent në shoqatë që nga mesi i viteve të 90-ta, pasi janë pensionuar i ri si i punësuar në institucion edukativo-korrektues. Si pensionist i ri, shumë vite kam marrë pjesë si garues në garat sportive të pensionistëve. Atmosfera e mirë, shoqërimi dhe jeta e organizuar e pensionistëve në Shoqatë me nxitën që të angazhohem edhe më shumë dhe të kontribuojë në punën dhe zhvillimin e shoqatës

INTERVISTË ME KRYETARIN E SHP TETOVË, SELVER MEMETI

SUKSESET E SHOQATËS, SI REZULTAT I PUNËS SONË EKIPORE



sonë. Pastaj në dy mandate isha anëtar i Këshillit ekzekutiv dhe i Kuvendit. Është e radhës të theksoj në këtë rast se në SHP Tetovë, vite me radhë bëhet një politikë e suksesshme kadrovike. Nuk mund të zgjidhet kryetar i shoqatës dikush që deri atëherë asnjëherë nuk ka qenë anëtar i Kuvendit, e posaçërisht anëtar i KE dhe nuk është daluar me punën e tij. Sa i përket përbërjes multietnike të anëtarësisë, ajo aspak nuk paraqet ndonjë problem, por përkundrazi ne si pensionistë jemi promotorë të bashkëjetesës në mjedisin tonë. Kjo mund të shihet në të gjitha fushëprimet, posaçërisht në jetën kulturore dhe argëtuese dhe aktivitetet sportive, dhe si kurorë e tërë asaj është organizimi i takimit tradicional multietnik të pensionistëve me pjesëmarrje të pensionistëve nga të gjitha bashkësitë etnike në këngë e muzikë të folklorit të të gjitha bashkësive. Motoja ime jetësore është: Bashkëjetesa, bashkimi dhe respekti i ndërsjellë janë shumë të rëndësishëm, ndërsa "dobësia" ime e veçantë çdo herë kanë qenë personat e gjeneratës së tretë dhe respekti ndaj tyre. Prandaj unë i hyra kësaj!

SHP Tetovë është ndër shoqatë

tat më të rralla që shumë herë ka qenë më e mira në Garat republikane sportive të organizuara nga LSHPM. Si rezultat i çka është ajo?

Memti: I qasjes së drejtë dhe serioze ndaj sportit dhe aktiviteteve sportive. Qasja duhet të jetë e tillë për shkakun se shumë mund jepet për këtë aktivitet. Angazhohen pensionistë ish sportistë dhe punëtorë sportiv, furnizohet e gjithë pajisja sportive për të gjithë ata, ushtrohet një muaj dy herë në javë para garave dhe ai është çelësi i suksesit.


A ka shoqata edhe aktivitet tjera me të cilat mund të mburret?

Memti: Vitin e kaluar, për shkak të pandemisë, nuk patëm mundësi të organizojmë një pjesë të madhe të aktiviteteve të planifikuara, megjithatë, në vitin 2020, te ne është punuar rregullisht sepse u shfaq nevoja e realizimit të aktiviteteve që nuk ishin të përfshira në Program. Kështu për shembull, çdo muaj, së paku një herë në muaj, vet kemi bërë dezinfektimin e tërë Shtëpisë së pensionistëve, kemi rinovuar Shtëpinë pjesë pas pjesë, kemi rregulluar oborrin, krahas ndihmës së planifikuar të një hershme financiare, gjatë periudhës së

pandemisë, në bashkëpunim me supermarketet "Kiper" kemi shpërndarë vauçerë me vlerë për 130 pensionistë dhe sërë aktivitete tjera. Secili kryetar i ri, ashtu edhe unë, vetëm e vazhdojmë politikën e përpiluar në pajtim me Statutin tonë dhe Ligjin në bazë afatgjate. Koha dikton, krahas asaj që të futen edhe risi në punë, jo të natyrës organizative, por si aktivitete të reja dhe të nevojshme të përpiluara në programet tona. Nga ky vit përmes organizatës joqeveritare CDI (Instituti për zhvillim të bashkësive) do të bëjmë trajnime praktike për aftësi kompjuterike, ndërsa do të ketë edhe sërë aktivitete tjera që do të dalin si pashmangshmëri gjatë këtij viti.

SHP suksesshëm funksionon nën udhëheqjen Tuaj. Si rezultat i çka është ajo: i përvojës suaj të mëhershme para pensionimit apo ekipit të mirë të zgjedhur me të cilin punoni?

Memti: Unë jam pensionist me arsim sipëror, kam punuar disa vite si punonjës arsimor, ndërsa jam pensionuar si i punësuar në institucion edukativ-korrektues. Ato janë vende të punës ku njihen dallimet dhe nevojat e njerëzve. Ajo është përvojë shumë e madhe. Atë punë e kam kryer me shumë sukses për çka posedoj një numër të madh të mirënjohjeve dhe certifikatave. Megjithatë, mendoj se më së shumti më ka ndihmuar në punën time përvoja që gjatë dy mandateve e kam marrë si anëtar i Kuvendit dhe KE. Secili do të ishte gënjyer nëse mendon se vet me sukses mund të udhëheqë me një shoqatë si e jona me numër të madh të pensionistëve, nga mjediset urbane dhe rurale dhe me përbërje të përzier etnike. Suksesi ynë është si rezultat i punës ekipore, si dhe përvojës së madhe



që e posedon sekretari ynë, në sferën e jetës së organizuar të pensionistëve. Është kënaqësi të punohet me përbërjen e tanishme të Këshillit ekzekutiv. Me një përbërje të tillë nuk është vështirë të realizosh detyrën e kryetarit.

Në fund, krahas punës në shoqatë, a keni kohë për vete, për familjen? Çka ju relakson gjatë kohës së lirë? A keni ndonjë hobi?

Memti: Kur do, ka kohë për çdo gjë. Në shoqatë jam i angazhuar 6 orë në ditë. Për fat të mirë jetoj shumë afër Shtëpisë së pensionistëve, që do të thotë se nuk humbi kohë duke udhëtuar. Jetoj në një mjedis familjar me djalin dhe nipat. Koha me kaluar me ata është më e vlefshme. Orët e mbrëmjes i kaloj në shëtitje me gruan time nëpër qytet, ndërsa ndonjëherë me shokët dhe miqtë e mi dua të luaj ndonjë lojë shah ose oksan. Hobi më i madh për mua është të shëtiturit nëpër natyrë, pasi që vij nga pjesa e Malit Sharr, jam adhures i madh i natyrës. Megjithatë, kushtet e sotme jetësore, detyrat e punës, obligimet ndaj familjes dhe nipave, lënë hapësirë për hobin tim vetëm gjatë vikendeve. Jam adhures i madh edhe i takimeve të organizuara të pensionistëve, duke u njohur dhe shoqëruar me kolegët tanë të qyteteve tjera, megjithatë në vitin 2020, për shkak të pandemisë kjo dëshirë më mbeti e paralizuar. Shpresojmë që viti 2021 të jetë më i mirë dhe do të mund t'i realizojmë të gjitha dëshirat tona. Svetozar Dimovski

SHP ÇAIR

NJË RETROSPEKTIVË E AKTIVITETEVE GJATË VITIT TË KALUAR

Kah fundi i vitit të kaluar, ndërsa në kuadër të aktiviteteve të planifikuara, KE pranë SHP Çair më 23 dhjetor ka mbajtur seancën e tetë të rregullt, në të cilën u prezantua një retrospektivë e aktiviteteve në të gjitha fushat gjatë vitit të kaluar. Pas miratimit të procesverbalit nga seanca e kaluar dhe rendit të ditës, fjalim hyrës për rezultatet e arritura në kushte të Covid-19 në vitin 2020 mbajti koordinatori i shoqatës, Todor Iliev, ku theksoi problemet dhe kushtet e pavolitshme që vështirësojnë funksionimin e shoqatës.

Në seancë u shqyrtuan disa dokumente të rëndësishme dhe

njësori u miratuan. Mes tyre ishte Raporti vjetor i punës së SHP Çair në vitin 2020 dhe Propozim programi për punë për vitin 2021. U miratua edhe Propozim plani financiar për të hyrat dhe shpenzimet e shoqatës për vitin 2021. Pikat tjera të rendit të ditës ishin si sjellja e Vendimit për financim të SHP Çair në tremujorin e parë të vitit 2021, shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të regjistrimit të realizuar të mjeteve themelore të SHP Çair për vitin 2020.

Raporti i punës së shoqatës në vitin 2020, ishte pika për të cilën u zhvillua një diskutim më i gjërë, ku u theksua se programi nuk pati

mundësinë të realizohet në tërësi në kushte të pandemisë. U soll konkluzioni se shoqata nuk ka realizuar programin në tërësi, por megjithatë ka arritur rezultate të konsiderueshme në ndërmarrjen e masave, e posaçërisht në këto kushte të pavolitshme për përmirësimin e cilësisë së jetës së pensionistëve. Si rezultat i punës së mirë të udhëheqësisë, organeve dhe trupave në kushte të pandemisë, janë realizuar një pjesë e madhe e detyrave të parapara, që do të thotë se është realizuar me sukses ajo që është hartuar, që ka kontribuar në ecjen përpara të shoqatës.



Diskutime konstruktive janë bërë edhe në lidhje me Propozim programin për punë të SHP për vitin 2021 ku u numëruan aktivitetet që do të realizohen në shoqatë, si dhe në lidhje me Propozim planin financiar për vitin 2021. Aktivitetet e planifikuara për vitin 2021 janë paraparë për në kushte normale. Nëse zgjatë pandemia, është e nevojshme që shoqata të aftësohet

të punojë edhe në kushte të tilla. Në diskutimin në lidhje me Propozim programin e planit financiar për vitin 2021 u theksua se në rast të vazhdimit të pandemisë, t'i jepet rëndësi më e madhe ndihmës së njehershme dhe asaj humanitare, ku është e mundshme të shfaqet nevoja edhe për ndihmë të jashtëzakonshme humanitare. Vasil Paçemski